



COME...

*Percorsi di accoglienza, integrazione,
educazione interculturale*

AI RAGAZZI E AI GENITORI STRANIERI

NXËNËSVE DHE PRINDËRVE TË HUAJ

Testo in lingua albanese



Come funziona la scuola superiore in Italia
Prime informazioni per l'accoglienza

Si funksionon shkolla e mesme në Itali
Informacionet fillestare për pritjen

Benvenuto nella scuola italiana

Cari ragazzi, cari genitori,

è difficile, per voi che arrivate da paesi stranieri, orientarvi nel panorama della scuola italiana per scegliere il corso di studi più vicino alle vostre esigenze e alle vostre speranze per il futuro.

Questo libretto, con la traduzione nella lingua dei diversi paesi d'origine, vi sarà d'aiuto dandovi indicazioni utili a conoscere il nostro sistema scolastico

Il modo migliore per darvi il benvenuto ed augurarvi un'esperienza serena e positiva nella scuola di tutti è offrirvi uno strumento nella vostra lingua perché possiate scegliere insieme, con consapevolezza.

L'Assessore all'Istruzione e all'Edilizia Scolastica
Giansandro Barzaghi

Mirëserdhe në shkollën italiane

Të dashur nxënës, të dashur prindër,

është e vështirë, për ju që vini nga vende të huaja, të orientoheni në panoramën e shkollës italiane për të zgjedhur kursin e studimit më të përshtatshëm për kërkesat dhe shpresat e juaja për të ardhmen.

Ky libërth, i përkthyer në gjuhën e vendeve të origjinës, do t'ju ndihmojë duke ju dhënë udhëzime të dobishme për të njohur sistemin tonë shkollor.

Mënyra më e mirë për t'ju uruar mirëseardhjen dhe për t'ju përcjellë urimet më të përzemërta për një përvojë të qetë e të këndshme në shkollën e të gjithëve është t'ju ofrojmë një mjet në gjuhën tuaj në mënyrë që të mund të zgjidhni së bashku, me vetëdije.

Përgjegjësi për Arsimin e Ndërtimet Shkollore
Giansandro Barzaghi

Presentazione del sistema scolastico in Italia

Il sistema scolastico	pag. 4
La scelta dopo i 14 anni	pag. 5
Le scuole secondarie superiori o di "secondo grado"	pag. 6
Quale scuola secondaria ?	pag. 7

Accoglienza nella scuola

Cosa fare per iscriversi a scuola	pag. 9
Informazioni sul calendario scolastico	pag.10
Cosa si fa a scuola	pag.11

Scuole in due parole

Licei	pag.12
Istruzione tecnica	pag.14
Istruzione professionale; formazione professionale	pag.17

Notizie utili	pag.18
Indirizzi utili	pag.19
Scheda informativa a cura della scuola	pag.20

Paraqitja e sistemit shkollor në Itali

Sistemi shkollor	f. 4
Zgjedhja pas moshës 14 vjeç	f. 5
Shkollat sekondare superiore ose të "gradës së dytë"	f. 6
Cilën shkollë sekondare?	f. 7

Pritja në shkollë

Çfarë duhet bërë për t'u regjistruar në shkollë	f. 9
Informacione për kalendarin shkollor	f.10
Çfarë bëhet në shkollë	f.11

Shkollat me dy fjalë

Licetë	f.12
Arsimi teknik	f.14
Arsimi profesional; formimi profesional	f.17

Lajme të dobishme	f.18
Adresa të dobishme	f.19
Skeda informuese nën kujdesin e shkollës	f.20

Attenzione !


- Sei arrivato da poco in Italia ? Leggi a pagina 9
- Non hai il diploma di licenza media ? Leggi a pagina 5
- Non sai quale scuola superiore scegliere ? Leggi da pagina 12 a pagina 17

Kujdes !


- Ke pak kohë në Itali ? Lexo në faqen 9
- Nuk e ke dëftesën e shkollës tetëvjeçare ? Lexo në faqen 5
- Nuk di se çfarë shkolle të mesme të zgjedhësh ? Lexo nga faqja 12 në faqen 17

Il sistema scolastico italiano

In Italia ogni alunno deve frequentare la scuola o la formazione professionale sino ai 18 anni. Questo diritto / dovere riguarda tutti gli alunni stranieri, regolari e irregolari, con o senza il permesso di soggiorno.



* è possibile iniziare la scuola dell'infanzia a due anni e mezzo e la scuola primaria a cinque anni e mezzo



* shkolla e fëmijërisë mund të fillohet në moshën dy vjeç e gjysmë dhe shkolla primare pesë vjeç e gjysmë

Sistemi shkollor italian

Në Itali çdo nxënës duhet të bëjë shkollë ose formim profesional deri në moshën 18 vjeç. Kjo e drejtë / detyrë u takon të gjithë nxënësve të huaj, të rregullt e të parregullt, me ose pa lejeqëndrim.



COSA DICE LA LEGGE

Decreto Legislativo 15 aprile 2005, n. 76. Articolo 1.

Diritto-dovere all'istruzione e alla formazione

La fruizione dell'offerta di istruzione e di formazione costituisce un diritto e un dovere per i minori stranieri per almeno dodici anni e fino al diciottesimo anno di età.

ÇFARË THOTË LIGJI

Dekreti Legjislativ 15 prill 2005, n. 76. Neni 1.

E drejta-detyrë për arsim e për formim

Përdorimi i ofertës për arsim e formim përbën një të drejtë dhe detyrë për të miturit e huaj për të paktën dymbëdhjetë vjet e deri në moshën tetëmbëdhjetë vjeç.

La scelta dopo i 14 anni

Se hai **14 anni** e **il diploma** di scuola media italiana (scuola di 1° grado) o un titolo equivalente:

- ✓ puoi iscriverti ad una scuola superiore (scuola di 2° grado)

Se hai **14 anni** ma **non hai il diploma** di scuola media:

- ✓ puoi iscriverti alla scuola media per ottenere il diploma

Se hai **15 anni** (o più) e **il diploma** di scuola media italiana o un titolo equivalente:

- ✓ puoi iscriverti alla scuola superiore, oppure
- ✓ puoi iscriverti ad un corso di formazione professionale
- ✓ puoi frequentare contemporaneamente un corso in un C.T.P. (centro territoriale permanente) per imparare l'italiano

Se hai **15 anni** ma **non hai il diploma** di scuola media italiana:

- ✓ se hai frequentato almeno 9 anni di scuola nel tuo paese, puoi iscriverti alla scuola superiore, oppure
- ✓ puoi iscriverti ad un corso di formazione professionale
- ✓ puoi frequentare contemporaneamente un corso in un C.T.P. (centro territoriale permanente) per imparare l'italiano e ottenere il diploma di scuola media

Zgjedhja pas moshës 14 vjeç

Nëse je **14 vjeç** dhe ke **dëftesën (diplomën)** e shkollës tetëvjeçare italiane (shkolla e gradës I) ose një titull të barasvlershëm:

- ✓ mund të regjistrohesh në një shkollë të mesme (shkolla e gradës II)

Nëse je **14 vjeç** por **nuk e ke dëftesën** e shkollës tetëvjeçare:

- ✓ mund të regjistrohesh në shkollën tetëvjeçare për të marrë dëftesën

Nëse je **15 vjeç** (ose më shumë) dhe e ke **dëftesën** e shkollës tetëvjeçare italiane ose një titull të barasvlershëm:

- ✓ mund të regjistrohesh në shkollën e mesme, ose
- ✓ mund të regjistrohesh në një kurs formimi profesional
- ✓ mund të bësh njëkohësisht një kurs në një C.T.P. (qendër territoriale e përhershme) për të mësuar italishten

Nëse je **15 vjeç** por **nuk e ke dëftesën** e shkollës tetëvjeçare italiane:

- ✓ nëse ke bërë të paktën 9 vjet shkollë në vendin tënd, mund të regjistrohesh në shkollën e mesme (superiore), ose
- ✓ mund të regjistrohesh në një kurs formimi profesional
- ✓ mund të bësh njëkohësisht një kurs në një C.T.P. (qendër territoriale e përhershme) për të mësuar italishten dhe për të marrë dëftesën e shkollës tetëvjeçare

Le scuole “secondarie superiori” o “di secondo grado”

In Italia ci sono diversi tipi di scuole con molti corsi e piani di studio.

Tutti i corsi di studio durano 5 anni e si concludono con un “esame di stato”. Gli alunni che superano l’esame ottengono un “diploma”. Dopo il diploma si può iniziare a lavorare oppure proseguire gli studi nelle Università.

Negli istituti professionali alla fine del terzo anno c’è un esame “di qualifica”. Dopo questo esame si può iniziare a lavorare oppure si può proseguire per altri 2 anni di studio e ottenere il diploma finale. Questo diploma finale è un titolo più completo, di livello più elevato e permette anche di proseguire gli studi nelle Università.

Attenzione ! Hai già compiuto 15 anni ?

- se hai il diploma della scuola secondaria di primo grado italiana o un titolo equivalente, puoi iscriverti direttamente alla scuola superiore

- se non hai il diploma, ma hai frequentato la scuola per almeno 9 anni nel tuo paese, puoi iscriverti alla scuola superiore e contemporaneamente frequentare un corso presso i C.T.P. (centri territoriali permanenti) per ottenere il diploma.

- se non hai il diploma e non hai frequentato almeno 9 anni di scuola nel tuo paese, puoi comunque iscriverti ai C.T.P. e, dopo il diploma, alla scuola superiore



COSA DICE LA LEGGE

Circolare n°93/2005 che richiama il Decreto Legge n°76/2005 per promuovere tutti gli interventi necessari per il conseguimento del titolo conclusivo del primo ciclo

Shkollat “sekondare superiore” ose të “gradës së dytë”

Në Itali ka lloje të ndryshme shkollash me shumë kurse dhe plane studimi.

Të gjitha kurset e studimit zgjasin 5 vjet dhe përfundojnë me një “provim shtetëror”. Nxënësit që e kalojnë provimin marrin një “diplomë”. Pas diplomës mund të fillojnë të punojnë ose të vazhdojnë studimet në Universitet.

Në institutet profesionale në fund të vitit të tretë zhvillohet një provim “kualifikimi”. Pas këtij provimi mund të punohet ose mund të vazhdohet studimi për 2 vjet të tjera dhe të merret diploma përfundimtare. Kjo diplomë përfundimtare është titull më i plotë, me nivel më të lartë dhe të lejon të vazhdosh studimet në Universitet.

Kujdes ! E ke mbushur moshën 15 vjeç ?

- nëse e ke diplomën e shkollës sekondare të gradës së parë italiane ose një titull të barasvlershëm, mund të regjistrohesh drejtpërdrejt në shkollën e mesme

- nëse nuk e ke diplomën, por e ke frekuentuar shkollën për të paktën 9 vjet në vendin tënd, mund të regjistrohesh në shkollën e mesme dhe njëkohësisht të bësh një kurs pranë C.T.P. (qendra territoriale të përhershme) për të marrë diplomën.

- nëse nuk e ke diplomën dhe nuk ke frekuentuar të paktën 9 vjet shkollë në vendin tënd, mund të regjistrohesh gjithsesi në C.T.P. dhe, pas diplomës, në shkollën e mesme

ÇFARË THOTË LIGJI

Qarkore n°93/2005 që i referohet Dekret Ligjit n° 76/2005 për të nxitur të gjitha ndërhyrjet e nevojshme për marrjen e titullit përmbyllës të ciklit të parë

Quale scuola secondaria ?

In questa tabella trovate un elenco dei vari tipi di scuole.
Da pagina 12 a pagina 17 troverete una descrizione in breve dei diversi tipi di scuola.

Molte scuole hanno anche classi con “sperimentazioni” o “progetti”, cioè classi nelle quali le materie o il numero di ore delle materie sono differenti da quelle tradizionali.

Potete trovare l’elenco di queste sperimentazioni e progetti nella pubblicazione della Provincia di Milano “ ITER” (ultima edizione), o domandare informazioni agli “Sportelli Territoriali di Orientamento” della Provincia di Milano (indirizzi a pagina 19).

<i>Denominazione scuola</i>	<i>durata</i>	<i>Titolo rilasciato</i>	
Istruzione liceale Indirizzi: Liceo Classico; Scientifico; Linguistico	5 anni	Diploma di istruzione secondaria superiore a indirizzo classico, scientifico o linguistico	pagina 12
Istruzione artistica e musicale Indirizzi: Architettura e Design; Beni culturali; Disegno ed espressione figurativa; Grafica e Multimedialità; Musicale	5 anni	Diploma di istruzione secondaria superiore a indirizzo artistico o musicale	pagina 13
“Scienze Umane” ex Istruzione Magistrale Indirizzi: Scienze Sociali; Socio-psico-pedagogico; Scienze della Formazione	5 anni	Diploma di istruzione secondaria superiore a indirizzo scienze sociali o socio-pedagogico	pagina 13
Istruzione Tecnica Indirizzi: Chimica; Fisica e Biologia; Edile-territoriale (geometri); Elettronica; Informatica e Telecomunicazioni; Elettrotecnica e Automazione; Grafica e multimedialità; Meccanica; Impiantistica ed Energetica; Sanitario; Giuridico-economico-aziendale; Comunicazione e Marketing; Trasporti; Servizi ai trasporti; Agro-alimentare; Servizi turistici	5 anni	Diploma di istruzione secondaria superiore a indirizzo tecnico. Perito nella specifica area	pagina 14
Istruzione professionale Indirizzi: Chimica; Fisica e Biologia; Legno e Arredamento; Elettronica; Informatica e Telecomunicazioni; Elettrotecnica e Automazione; Meccanica; Impiantistica ed Energetica; Moda e Abbigliamento; Grafica e Multimedialità; Agro-alimentare; Sanitario; Grafica e Multimedialità; Giuridico-economico-aziendale; Sociale; Servizi turistici; Servizi alberghieri e della ristorazione	3 + 2 anni	Diploma di qualifica professionale nell’area specifica (3 anni) Diploma di istruzione secondaria superiore a indirizzo professionale. Tecnico nella specifica area (2 anni)	pagina 17

Cilën shkollë sekondare ?

Në këtë tabelë do të gjeni një listë të llojeve të ndryshme të shkollës.

Nga faqja 12 në faqen 17 do të gjeni një përshkrim të shkurtër të llojeve të ndryshme të shkollës.

Shumë shkolla kanë edhe klasa me “eksperimentime” ose me “projekte”, dmth klasa në të cilat lëndët ose numri i orëve të lëndëve janë të ndryshme nga ato tradicionalet.

Mund ta gjeni listën e këtyre eksperimentimeve dhe projekteve në botimin e Provincës së Milanos “ ITER” (botimi i fundit), ose të kërkonte informacion në “Sportelet Territoriale të Orientimit” të Provincës së Milanos (adresat në faqen 19).

<i>Emri i shkollës</i>	<i>Koha</i>	<i>Titulli i lëshuar</i>	
Arsimi liceal Degët: Liceu Klasik; Shkencor; Gjuhësor	5 vjet	Diploma e arsimit sekondar të lartë në degën klasike, shkencore ose gjuhësore	faqe 12
Arsim artistik e muzikor Degët: Arkitekturë e Design; Të Mirat Kulturore; Vizatim dhe shprehje figurative; Art grafik e Multimedialitet; Muzikor	5 vjet	Diploma e arsimit sekondar superior në degën artistike ose muzikore	faqe 13
“Shkenca Njerëzore” ish arsimi Pedagogjik Degët: Shkencat Shoqërore; Socio-psiko-pedagogjik; Shkencat e Formimit	5 vjet	Diploma e arsimit sekondar superior në degën shkencat shoqërore ose socio-pedagogjike	faqe 13
Arsimi Teknik Degët: Kimi; Fizikë e Biologji; Ndërtim-territorial (gjeometri); Elektronikë; Informatikë e Telekomunikacion; Elektroteknikë e Automatizim; Art grafik e multimedialitet; Mekanikë; Ndërtim impiantesh dhe Energjetikë; Sanitare; Juridik-ekonomik-ndërmarrje; Komunikim e Marketing; Transport; Shërbime transporti; Agro-ushqimor; Shërbime turistike	5 vjet	Diploma e arsimit sekondar superior në degën teknike. Teknik në fushën specifike	faqe 14
Arsim profesional Degët: Kimi; Fizikë e Biologji; Dru e Mobilim; Elektronikë; Informatikë e Telekomunikacion; Elektroteknikë e Automatizim; Mekanikë; Ndërtim impiantesh dhe Energjetikë; Modë e Veshje; Art grafik e multimedialitet; Agro-ushqimor; Sanitare; Art grafik e multimedialitet; Juridik-ekonomik-ndërmarrje; Shoqëror; Shërbime turistike; Shërbime hotel e restorant	3 + 2 vjet	Diploma e kualifikimit profesional në fushën specifike (3 vjet) Diploma e arsimit sekondar superior në degën profesionale. Teknik në fushën specifike (2 vjet)	faqe 17

Come fare per iscriversi a scuola

Per iscriversi bisogna compilare un modulo e presentare i documenti richiesti direttamente alla segreteria della scuola.

Documenti anagrafici

- carta di identità
 - codice fiscale
 - certificato di nascita
 - atto di cittadinanza
- o autocertificazione dei dati richiesti

Documenti sanitari

La scuola richiede un certificato delle vaccinazioni fatte. In mancanza di questo documento gli alunni possono comunque iniziare la scuola. Le famiglie possono rivolgersi alle ASL (aziende sanitarie locali, www.asl.milano.it) per il controllo della documentazione o per il completamento delle vaccinazioni.

Documenti scolastici

La scuola richiede un documento degli studi fatti nel paese d'origine, tradotto in lingua italiana. In attesa del documento i genitori dichiarano e autocertificano la classe ed il tipo di scuola frequentata nel paese d'origine.

Attenzione!

*Se sei arrivato da poco in Italia, non perdere tempo!
Iscriviti e vai a scuola subito, puoi farlo anche se le lezioni sono già iniziate.*

Se non hai ancora tutti i documenti, puoi comunque iscriverti e andare a scuola.

Se hai meno di 18 anni, puoi iscriverti anche senza il permesso di soggiorno.



COSA DICE LA LEGGE

D.P.R. 394/99 art45; Circolare n°93/2005 sulle iscrizioni scolastiche; Linee guida del MIUR del 16 febbraio 2006 per l'accoglienza e l'integrazione degli alunni stranieri

Çfarë duhet bërë për t'u regjistruar në shkollë

Për t'u regjistruar duhet mbushur një formular dhe duhen paraqitur dokumentet e kërkuara drejtpërdrejt në sekretarinë e shkollës.

Dokumente me të dhëna personale

- karta e identitetit
 - kodi fiskal
 - certifikata e lindjes
 - akti i shtetësisë
- ose vetëcertifikimi i të dhënave të kërkuara

Dokumente shëndetësore

Shkolla kërkon një certifikatë për vaksinat e bëra. Në mungesë të këtij dokumenti nxënësit mund ta fillojnë gjithsesi shkollën. Familjet mund të drejtohen në ASL (ndërmarrje shëndetësore lokale, www.asl.milano.it) për kontrollin e dokumentimit ose për plotësimin e vaksinave.

Dokumente shkollore

Shkolla kërkon një dokument të studimeve të bëra në vendin e origjinës, përkthyer në gjuhën italiane. Në pritje të dokumentit prindërit deklarojnë dhe vetëcertifikojnë klasën dhe llojin e shkollës së bërë në vendin e origjinës.

Kujdes!

*Nëse ke pak që ke ardhur në Itali, mos humb kohë!
Regjistrohu e shko në shkollë menjëherë, mund ta bësh edhe pse leksionet kanë filluar prej kohësh.
Nëse nuk i ke ende të gjitha dokumentet, mund të regjistrohesh gjithsesi e të shkosh në shkollë.
Nëse je më pak se 18 vjeç, mund të regjistrohesh edhe pa lejeqëndrim.*

ÇFARË THOTË LIGJI

D.P.R. 394/99 neni 45; Qarkore n°93/2005 për regjistrimet shkollore; Udhëzime të MIUR të datës 16 shkurt 2006 për pritjen dhe integrimin e nxënësve të huaj

Informazioni sul calendario scolastico

L'anno scolastico

L'anno scolastico dura nove mesi. Le lezioni iniziano nella prima metà di settembre e terminano entro i primi dieci giorni di giugno.

Ci sono dei periodi di vacanza già stabiliti:

- vacanze di Natale;
- vacanze di Pasqua;
- feste civili o religiose.

La giornata scolastica

Le lezioni, obbligatorie, cominciano alle 8 di mattina circa e finiscono alle 13,30 circa. Alcune scuole hanno lezione anche al pomeriggio.

Ogni classe è composta da ragazze e ragazzi. Tutte le materie di studio sono obbligatorie. L'insegnamento della religione cattolica è facoltativo.

Alcune scuole organizzano nel pomeriggio attività a scelta e corsi di sostegno e recupero.

Assenze e ritardi

Le assenze, i ritardi o le uscite anticipate da scuola devono essere giustificati dai genitori sul libretto scolastico.

Informazione për kalendarin shkollor

Viti shkollor

Viti shkollor zgjat nëntë muaj. Leksionet fillojnë në gjysmën e parë të shtatorit e mbarojnë brenda dhjetë ditët e para të qershorit.

Ka periudha pushimi të paracaktuara:

- pushimet e Krishtlindjeve;
- pushimet e Pashkëve;
- festat civile ose fetare.

Dita e shkollës

Leksionet, e detyrueshme, fillojnë rreth orës 8 të mëngjesit e mbarojnë rreth orës 13,30. Disa shkolla bëjnë mësim edhe pasdite.

Çdo klasë përbëhet nga vajza e djem. Të gjitha lëndët e studimit janë të detyrueshme. Mësimi i fesë katolike është fakultative. Disa shkolla organizojnë pasdite veprimtari sipas dëshirës dhe kurse mbështetëse dhe rimarrjeje.

Mungesa e vonesa

Mungesat, vonesat ose daljet përpara kohe nga shkolla duhen justifikuar nga prindërit tek librezat shkollorë.

Cosa si fa a scuola

Materie di base

Le materie di base, che sono comuni a tutte le scuole, sono: italiano, storia, matematica, lingua straniera.

I progetti delle scuole

Ogni scuola, oltre alle materie obbligatorie, propone agli alunni progetti con altre attività. Tali progetti possono svolgersi durante la mattina o al pomeriggio. L'insieme dei progetti si chiama *Piano dell'Offerta Formativa (P.O.F.)*.

Stage e tirocinio

Sono previste esperienze di formazione / lavoro (non retribuito) fuori dalla scuola, chiamate "stage e tirocini".

Altre attività

Le scuole spesso organizzano visite didattiche (musei, mostre, teatri, ecc.) e viaggi d'istruzione.

Çfarë bëhet në shkollë

Lëndët kryesore

Lëndët kryesore, që janë të njëjta në të gjitha shkollat, janë: italishtja, historia, matematica, gjuha e huaj.

Projektet e shkollave

Çdo shkollë, përveç lëndëve të detyrueshme, u propozon nxënësve projekte me veprimtari të tjera. Projekte të tilla mund të zhvillohen gjatë mëngjesit ose pasdite. Tërësia e projekteve quhet *Plani i Ofertës së Formimit (P.O.F.)*.

Stazhi dhe praktika

Parashikohen përvoja formimi / pune (pa pagesë) jashtë shkollës, që quhen "stazh dhe praktika".

Veprimtari të tjera

Shkollat shpesh organizojnë vizita didaktike (muze, ekspozita, teatro, etj.) dhe udhëtime mësimore.

Scuole in due parole

Che cosa sono i licei

Gli studenti che frequentano i licei ottengono un diploma “di maturità” ma, in genere, prevedono di continuare gli studi nelle università.

Liceo classico

Le materie principali sono lingua e letteratura italiana, latina e greca antica, storia e filosofia, fisica e matematica.

Liceo scientifico

Le materie principali sono scienze, fisica, matematica, italiano, latino, lingua straniera, storia, filosofia.

Liceo linguistico

Gli alunni studiano italiano, latino e filosofia, 3 lingue straniere, matematica e informatica, linguaggi artistico-visivi e storia dell'arte.



I licei prevedono in genere il proseguimento degli studi presso le università

Shkollat me dy fjalë

Çfarë janë licetë

Nxënësit që frekuentojnë licetë marrin një diplomë “pjekurie” por, në përgjithësi, mendojnë t'i vazhdojnë studimet në universitet.

Liceu klasik


Lëndët kryesore janë gjuha e letërsia italiane, gjuha latine e greke antike, historia e filozofia, fizika e matematica.

Liceu shkencor

Lëndët kryesore janë shkencat, fizika, matematica, italishtja, latinishtja, gjuha e huaj, historia, filozofia.

Liceu gjuhësor

Nxënësit studiojnë italisht, latinisht e filozofi, 3 gjuhë të huaja, matematikë e informatikë, gjuhët artistiko-pamore e historia e artit.



Licetë parashikojnë në përgjithësi vazhdimin e studimeve pranë universiteteve

☐ Liceo artistico e liceo musicale

In ogni differente indirizzo si studiano le materie di settore (per esempio disegno, storia dell'arte, musica) e le materie comuni (italiano, matematica, filosofia).

Gli indirizzi sono:

- *Architettura e Design*
- *Beni culturali*
- *Disegno ed Espressione Figurativa*
- *Grafica e Multimedialità*
- *Musicale*




*Proseguimento degli studi nelle università o in corsi professionalizzanti (Accademia di Belle Arti, Conservatorio musicale)
Attività lavorative nei settori artistici*

☐ Liceu artistik e liceu muzikor

Në çdo degë të ndryshme studiohen lëndët e sektorit (për shembull vizatimi, historia e artit, muzika) e lëndët e zakonshme (italishtja, matematika, filozofia).

Degët janë:

- *Arkitekturë e Design*
- *Të Mirat Kulturore*
- *Vizatim dhe shprehje figurative*
- *Art grafik e Multimedialitet*
- *Muzikë*



*Vazhdimi i studimeve në universitet ose në kurse profesionalizuese (Akademia e Arteve të Bukura, Konservatori muzikor)
Veprimtari pune në fushat artistike*

☐ “Scienze Umane” ex Istruzione Magistrale

Indirizzo scienze sociali

Indirizzo socio-psico-pedagogico

Indirizzo scienze della formazione

Le materie fondamentali sono italiano, latino, lingue straniere, arte, musica, filosofia, psicologia, pedagogia, sociologia, matematica.



*Proseguimento degli studi nelle università o in corsi professionalizzanti;
Attività lavorative nei settori educativi e sociali*


☐ “Shkencat Njerëzore” ish Arsimi Pedagogjik

Dega shkencat shoqërore

Dega socio-psiko-pedagogjike

Dega shkencat e formimit

Lëndët thelbësore janë italishtja, latinishtja, gjuhët e huaja, arti, muzika, filozofia, psikologjia, pedagogjia, sociologjia, matematica.



*Vazhdimi i studimeve në universitet ose në kurse profesionalizuese;
Veprimtari pune në fushat edukative e sociale*

Che cosa è l'istruzione tecnica

Gli studenti che frequentano i differenti corsi di istruzione tecnica ottengono un diploma che consente di lavorare subito nel proprio settore di specializzazione, oppure di proseguire gli studi nelle università.

Istruzione tecnica industriale

Nei diversi indirizzi si studiano le materie di settore (per esempio chimica, elettronica, meccanica, grafica, ecc.) e le materie di base (italiano, matematica, ecc.)

Indirizzi:

- *Chimica Fisica e Biologia*
- *Edile Territoriale*
- *Elettronica Informatica e Telecomunicazioni*
- *Elettrotecnica e Automazione*
- *Grafica e Multimedialità*
- *Meccanica Impiantistica e Energetica*
- *Sanitario*

Istruzione tecnica per geometri

Indirizzo edile territoriale

Le materie principali sono italiano, lingua straniera, disegno tecnico, tecnologia delle costruzioni, estimo e topografia.



*Possibilità di lavoro nel settore di indirizzo o di lavoro autonomo
Proseguimento degli studi nelle università*

Çfarë është arsimit teknik

Nxënësit që bëjnë kurset e ndryshme të arsimit teknik marrin një diploma që u lejon të punojnë menjëherë në sektorin e vet të specializimit, ose të vazhdojnë studimet në universitet.

Arsimit teknik industrial

Në degët e ndryshme studiohen lëndët e sektorit (për shembull kimia, elektronika, mekanika, grafika, etj.) dhe lëndët kryesore (italishtja, matematica, etj.)


Degët:

- *Kimi; Fizikë e Biologji*
- *Ndërtim-territorial*
- *Elektronikë Informatikë e Telekomunikacion*
- *Elektroteknikë e Automatizim*
- *Art grafik e multimedialitet*
- *Mekanikë Ndërtim impiantesh dhe Energjetikë*
- *Sanitare*

Arsim teknik për gjeometër

Dega ndërtim territorial

Lëndët kryesore janë italishtja, gjuha e huaj, vizatimi teknik, teknologjia e ndërtimit, vlerësimi e topografia.



*Mundësi pune në sektorin e degës ose punë e pavarur
Vazhdim i studimeve në universitet*

□ Istruzione tecnica commerciale

Indirizzo giuridico-amministrativo

il piano di studi fornisce competenze sia nel settore giuridico che in quello economico-aziendale. Gli alunni sviluppano capacità gestionali nelle imprese del settore industriale, commerciale, bancario, finanziario, assicurativo, nella pubblica amministrazione.

Indirizzo giuridico-economico-aziendale

Il piano di studi si fonda sempre sulle materie professionalizzanti, quali diritto, economia politica e aziendale, scienze delle finanze, 2 lingue straniere. Gli studenti sviluppano competenze nell'affrontare problemi di economia aziendale, la gestione aziendale, anche dal punto di vista economico, giuridico, organizzativo e contabile.

Indirizzo commerciale programmatore

Piano di studi simile al precedente, ma con una caratterizzazione informatica sia dal punto di vista del trattamento dei dati sia da quello della progettualità e programmazione.



*Possibilità di lavoro nel settore di indirizzo
Proseguimento degli studi nelle università*

□ Arsimi teknik tregtar

Dega juridike-administrative


plani i studimeve jep kompetenca si në sektorin juridik ashtu edhe në atë ekonomik-ndërmarrje. Nxënësit zhvillojnë aftësi administrative në ndërmarrje të sektorit industrial, tregtar, bankar, financiar, të sigurimeve, në administratën publike.

Dega juridike-ekonomike-ndërmarrje

Plani i studimeve bazohet gjithnjë mbi lëndët profesionalizuese, si e drejta, ekonomia politike dhe e ndërmarrjes, shkencat e financës, 2 gjuhë të huaja. Nxënësit zhvillojnë kompetenca në përballimin e problemeve të ekonomisë së ndërmarrjes, administrimin e ndërmarrjes, edhe nga pikëpamja ekonomike, juridike, organizative dhe të llogarive.

Dega tregtare e programuese

Plani i studimeve është i ngjashëm me të mëparshmin, por me një karakterizim informatik si nga pikëpamja e trajtimit të të dhënave ashtu edhe nga ajo e projektimit e programimit.



*Mundësi pune në sektorin e degës
Vazhdim i studimeve në universitet*

Istruzione tecnica per Periti Aziendali Corrispondenti in lingue estere

Indirizzo Comunicazione e Marketing

Il corso prevede lo studio di 2 oppure 3 lingue straniere, diritto, elementi di legislazione ed economia aziendale, matematica e informatica. Gli studenti ricevono una buona cultura generale e formazione nella comunicazione di impresa import/export, nelle relazioni aziendali internazionale, nel marketing e pubblicità.

Istruzione tecnica (altre)

Indirizzo Trasporti e Servizi ai trasporti

Le materie sono italiano, inglese, aeronautica, meteorologia, navigazione aerea. Gli studenti ricevono competenze tecnico-organizzative riguardo a traffico e legislazione nel settore aeronautico.

Indirizzo Agro-alimentare (economo-dietista; Perito agrario)

Il corso prepara tecnici specializzati nel settore agricoltura e nella produzione degli alimenti.

Indirizzo servizi turistici

Il corso prevede lo studio di 3 lingue straniere, geografia del turismo, storia dell'arte, matematica e informatica, economia aziendale, diritto, legislazione turistica, discipline turistiche aziendali.



*Possibilità di lavoro nel settore di indirizzo
Proseguimento degli studi nelle università*

Arsim teknik për Teknikë të Ndërmarrjeve Korrespondues në gjuhë të huaj

Dega Komunikim e Marketing

Kursi parashikon studimin e 2 ose 3 gjuhëve të huaja, të drejtën, elemente të legjislacionit dhe të ekonomisë së ndërmarrjes, matematikë e informatikë. Nxënësit marrin një kulturë të mirë të përgjithshme dhe formim në fushën e komunikimit të ndërmarrjes import/eksport, në marrëdhëniet ndërkombëtare të ndërmarrjes, në marketing e reklama.

Arsim teknik (të tjera)

Dega Transporte e Shërbime për transportin


Lëndë janë italishtja, anglishtja, aeronautika, meteorologjia, lundrimi ajror. Studentët marrin aftësi tekniko-organizative lidhur me trafikun dhe legjislacionin në sektorin aeronautik.

Dega Agro-ushqimore (ekonomat-dietist; Teknik agronom)

Kursi përgatit teknikë të specializuar në sektorin e bujqësisë dhe prodhimin e ushqimeve.

Dega e shërbimeve turistike

Kursi parashikon studimin e 3 gjuhëve të huaj, e lëndëve gjeografia e turizmit, historia e artit, matematika e informatika, ekonomia e ndërmarrjes, e drejta, legjislacioni turistik, disiplinat turistike e të ndërmarrjeve.



*Mundësi pune në sektorin e degës
Vazhdim i studimeve në universitet*

Che cosa è l'istruzione professionale

L'istruzione professionale ha un piano di studi pratico, per fare apprendere un mestiere o una professione. Dopo i primi 3 anni gli studenti ottengono un Diploma di Qualifica Professionale e possono iniziare a lavorare. Proseguendo per altri 2 anni si ottiene il Diploma di Istruzione Secondaria ad Indirizzo Professionale. Questo diploma dà maggiori possibilità di lavoro qualificato e permette di proseguire gli studi nelle università.

- Istruzione professionale: indirizzi
- *Industria e Artigianato*
- *Servizi della Pubblicità*
- *Servizi Commerciali*
- *Servizi Turistici Alberghieri*
- *Servizi Sociali*



Diploma di qualifica professionale (3 anni): possibilità di lavoro nel settore di indirizzo.
Diploma (3 + 2 anni): possibilità di lavoro nel settore di indirizzo
Proseguimento degli studi nelle università

Che cosa è la formazione professionale

Se vuoi frequentare una scuola più breve dove hai la possibilità di imparare subito una professione puoi scegliere tra i numerosi corsi di formazione professionale autorizzati dalla Regione Lombardia.

Questi corsi durano tre anni e si concludono con il diploma di qualifica professionale.

Consulta ITER o il sito <http://temi.provincia.mi.it/formazione/>


Çfarë është arsimi profesional

Arsimi profesional ka një plan studimi praktik, për të mësuar një zanat ose një profesion.

Pas 3 viteve të para nxënësit marrin një Diplomë Kualifikimi Profesional e mund të fillojnë punën.

Duke vazhduar për 2 vjet të tjera merret Diploma e Arsimit Sekondar në Degë Profesionale. Kjo diplomë jep mundësi pune të kualifikuar më të mëdha e mundëson vazhdimin e studimeve në universitet.

- Arsimi profesional: degët
- *Industria e Artizanat*
- *Shërbime për Reklamata*
- *Shërbime Tregtare*
- *Shërbime Turistike Hoteleri*
- *Shërbime Sociale*



Diploma e kualifikimit profesional (3 vjet): mundësi pune në sektorin e degës.
Diploma (3 + 2 vjet): mundësi pune në sektorin e degës
Vazhdim i studimeve në universitet

Çfarë është formimi profesional

Nëse dëshiron të bësh një shkollë më të shkurtër ku ke mundësi të mësosh menjëherë një profesion mund të zgjedhësh midis kurseve të shumta të formimit profesional të autorizuar nga Krahina e Lombardisë.

Këto kurse zgjasin tre vjet dhe përfundojnë me diplomën e kualifikimit profesional.

Konsulto ITER ose faqen internet

<http://temi.provincia.mi.it/formazione/>

Notizie utili

Esenzione dalle tasse

Chiedete alla segreteria della scuola informazioni per ridurre il pagamento delle tasse scolastiche

Borse di studio e libri di testo

La Provincia di Milano e i Comuni mettono a disposizione delle borse di studio per studenti stranieri. Per informazioni rivolgetevi agli uffici della Provincia e dei Comuni. Troverete gli indirizzi alla pagina seguente.

Sportelli territoriali

Gli sportelli territoriali di orientamento danno informazioni sui corsi di studio e sulle scuole del territorio. Troverete gli indirizzi alla pagina seguente.

ITER viaggio nel sistema di istruzione e di formazione dopo la scuola media

E' un libro pubblicato dalla Provincia di Milano e contiene indirizzi e piani di studio di tutte le scuole della provincia. Potete trovarlo presso le scuole e presso gli *sportelli territoriali di orientamento*. Potete anche scaricarlo da questo indirizzo internet:

<http://temi.provincia.mi.it/scuola/istruzione/orientamento.html>

Lajme të dobishme

Përjashtim nga taksat

Kërkojini sekretarisë së shkollës informacione për të ulur pagesën e taksave shkollore

Bursat e studimi dhe librat shkollore

Provincia e Milanos e Komunitat vënë në dispozicion bursa studimi për studentët e huaj. Për informacione drejtohuni në zyrat e Provincës e të Komunave. Adresat do t'i gjeni në faqen tjetër.

Sportelet territoriale

Sportelet territoriale të orientimit japin informacione për kurset e studimit dhe për shkollat e zonës. Adresat do t'i gjeni në faqen tjetër.

ITER udhëtim në sistemin e arsimit e të formimit pas shkollës tetëvjeçare

Libri është botuar nga Provincia e Milanos dhe përmban adresa e planet e studimit të të gjitha shkollave të provincës. Mund ta gjeni në shkolla dhe në *sportelet territoriale të orientimit*. Mund ta shkarkoni edhe nga kjo faqe internet:

<http://temi.provincia.mi.it/scuola/istruzione/orientamento.html>

Indirizzi utili

Sportelli territoriali di orientamento

- Centro scolastico di Bollate
Via Varalli, 20 – Bollate – Tel. 02 38300443
- ITCG PACLE “Argentia”
Via Adda, 2 – Gorgonzola – Tel. 02 95305831
- Centro Scolastico “Parco Nord”
Via Gorki, 100/106 – Cinisello Balsamo – Tel. 02 61294768
- Centro Scolastico di San Donato
Via Martiri di Cefalonia, 46 – S. Donato – Tel. 0255691222
- CIDI – “Reteorientamento Milano”
Via Settala, 19 – Milano – Tel. 02 29536488

Provincia di Milano, Assessorato all’Istruzione
Ufficio Integrazione studenti stranieri
Via Petrarca, 20 – Milano
Tel. 02 77404648
www.provincia.milano.it/scuola

Centro COME
Via Galvani, 16 – Milano
Tel. 02 67100792
www.centrocome.it

CTP centri territoriali permanenti
Viale Campania, 8 – Milano
Tel. 02 70 00 46 56

Adresa të dobishme

Spotelet territoriale të orientimit

- Centro scolastico di Bollate
Via Varalli, 20 – Bollate – Tel. 02 38300443
- ITCG PACLE “Argentia”
Via Adda, 2 – Gorgonzola – Tel. 02 95305831
- Centro Scolastico “Parco Nord”
Via Gorki, 100/106 – Cinisello Balsamo – Tel. 02 61294768
- Centro Scolastico di San Donato
Via Martiri di Cefalonia, 46 – S. Donato – Tel. 0255691222
- CIDI – “Reteorientamento Milano”
Via Settala, 19 – Milano – Tel. 02 29536488

Provincia di Milano, Assessorato all’Istruzione
Ufficio Integrazione studenti stranieri
Via Petrarca, 20 – Milano
Tel. 02 77404648
www.provincia.milano.it/scuola

Centro COME
Via Galvani, 16 – Milano
Tel. 02 67100792
www.centrocome.it

CTP centri territoriali permanenti
Viale Campania, 8 – Milano
Tel. 02 70 00 46 56

Scheda informativa a cura della scuola

Tipo di scuola

La descrizione di questa scuola è simile al profilo “in due parole” di pagina

Riferimenti utili

Nome scuola
Indirizzo
Telefono
Fax
e-mail

Preside
Vicepreside
Referente per gli alunni stranieri
Orario di apertura dello sportello di segreteria

In questa scuola

È possibile usare la biblioteca dallealle
La scuola è aperta dopo le lezioni dalle alle

Progetti per gli alunni stranieri

- Accoglienza e inserimento iniziale
- Orientamento alla scelta della scuola
- Corsi di lingua italiana
- Corsi aggiuntivi nelle lingue d'origine
- Corsi di sostegno nelle materie scolastiche
- Corsi di recupero e di preparazione per esami integrativi
- Materiale specifico per alunni stranieri
- Interventi di mediatori linguistico-culturali
- Altro

Skeda informuese nën kujdesin e shkollës

Lloji i shkollës

Përshkrimi i kësaj shkolle është i ngjashëm me profilin “me dy fjalë” të faqes

Referime të dobishme

Emri i shkollës
Adresa
Telefoni
Faksi
e-mail

Drejtori
Zv/drejtori
Referenti për nxënësit e huaj
Orari i hapjes së sportelit të sekretarisë

Në këtë shkollë

Biblioteka mund të përdoret nga oranë orën
Pas leksioneve shkolle është e hapur nga oranë orën

Projekte për nxënësit e huaj

- Pritja dhe integrimi fillestar
- Orientimi për zgjedhjen e shkollës
- Kurse për gjuhën italiane
- Kurse shtesë në gjuhët e origjinës
- Kurse mbështetëse në lëndët shkollore
- Kurse rimarrjeje dhe përgatitjeje për provimet integruese
- Material i posaçëm për nxënësit e huaj
- Ndërhyrje të ndërmjetësve gjuhësorë e kulturorë
- Tjetër